



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ .11.2024

Njoftim për “Vlerësues të moduleve/programeve të trajnimit dhe bashkëpunëtorë të komisionit të akreditimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional”

Në mbështetje të nenit 58, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.98, datë 27.02.2019, të Kryeministrit, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP), nenit 7 dhe nenet 10-12 të Urdhrit të Ministrit nr.32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, udhëzimit nr.16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, pikës 8.1/d në urdhrin nr. 157 prot., datë 23.09.2024 të drejtorit të përgjithshëm të ASCAP “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat dhe për kriteret e akreditimit dhe të njohjes së aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësit arsimorë”, urdhrin nr. 172 prot., datë 30.10.2024 të drejtorit të përgjithshëm të ASCAP “Për ngritjen e komisionit të akreditimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional; ASCAP shpall kërkesën për **“Vlerësues të moduleve/programeve të trajnimit dhe bashkëpunëtorë të komisionit të akreditimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional”** në fushat:

- Përdorimi i TIK në mësimdhënie – nxënie
- Kurrikula
- Mësimdhënia - të nxëniet - vlerësimi i nxënësit
- Etika, komunikimi dhe pedagogjia
- Drejtimi i shkollës dhe zhvillimi profesional i mësuesve
- Gjithëpërfshirja

Vlerësuesit dhe bashkëpunëtorët në këtë thirrje duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Mësues ose specialistë të fushës së arsimit parauniversitar që zotërojnë njohuri të mjaftueshme për modulin.
- b) Profesorë, lektorë, asistent-lektorë të institucioneve të arsimit të lartë në fushën e edukimit me ekspertizë në modulin përkatës.
- c) Mësues që janë vlerësuar “Shkëlqyeshëm” ose “Shumë mirë” në provimin e fundit të kualifikimit me ekspertizë në modulin përkatës.
- d) Drejtorë që drejtojnë shkolla të sukseshme në vitet e fundit shkollore.

Vlerësuesit e moduleve/ programeve të trajnimit nuk lejohet të jenë:

1. Autorë të moduleve/programeve të trajnimit.
2. Punonjës me kohë të plotë ose të pjesshme në agjencitë që aplikojnë për të akredituar modulet/programet e trajnimit.

Kandidati i interesuar duhet të paraqesë CV –në e tij pranë sekretarisë së ASCAP në adresën Rr: “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë, me postë, brenda datës 25.11.2024, ora 16.00.

Faleminderit!